REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr 6775/1 prot. Lushnje 19/08/2024

PROJEKT – VENDIM

NR. 72 DATË 19/08/2024

"PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.75 DATË 29.09.2023 DHE MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË EMERGJENCAVE CIVILE PËR VITIN 2024"

Këshillit Bashkiak Lushnje, në mbledhjen e datës ___/___/2024, pasi të marri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori për Planifikim dhe Përballimin e Emergjencave civile, Sektori i MNZSH, në mbështetje të nenit 9 pika 1.3, nenit 29 pika 2 të ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Neni 45 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH" i ndryshuar. Neni 44, neni 45 të Udhëzimt nr.09 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit". Neni 4, neni 8 shkronja "ç", neni 30 shkronja "f", neni 42 shkronja "b", neni 65 pika 2 të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile". Pika 1 shkronja "ë" të VKM nr.290, datë 17.05.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e proçedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile". Neni 113 të ligjit Nr.44/2015. "Kodi i Proçedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë" **JU:**

PROPOZOJMË:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.75 datë 29.09.2023 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të emergjencave civile viti 2023"

2. Miratimin "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar të emergjencave civile viti 2024 për blerjen e një mjeti zjarrëfikës në shumën 6.000.000 (gjashtë miljonë)lek.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori për Planifikimin dhe Përballimin e Emërgjencave Civile.Sektori i MNZSH,Drejtoria e Finance-Buxhetit,Drejtoria Juridike dhe Prokurorimeve (Zyra e Prokurorimeve).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKTORI PËR PLANIFIKIMIN DHE PËRBALLIMIN E EMËRGJENCAVE CIVILE.

Avni Begolli

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

SEKTORI I MNZSH

Xhezmi Metushi

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE, ZHVILLIMIT URBAN DHE RURAL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. 6616 Prot

Lushnje, më 12/08/2024

LËNDA: Kërkesë për blerjen e një mjeti zjarrfikës për nevojat e M.Z.SH.-së/Lushnje

KRYETARES SË BASHKISË.

Znj.ERISELDA SEFA.

Znj.Kryetare!

Ju vënë në dijeni se Sektori i MZSH-së, Bashkia Lushnje aktualisht ka në dispozicion në gjendje pune për kryerjen e detyrave të tij për përballimin e situatave të ndryshme të emergjencës si zjarre, përmbytje, aksidente të ndryshme,etj një park me automjete si më poshtë.

1. Zjarrfikëse e vogël Tip "Ford" kapacitet 200 l ujë.
2. Zjarrfikëse e mesme Tip "Reno" kapacitet 2000 l ujë.

Duke qenë se ky numër dhe lloj mjetesh që kemi në dispozicion nuk është i mjaftueshëm për territorin që ky sektor mbulon si dhe për shkallën e shumëllojshmërisë së varianteve të ndryshme të situatave që lindin në terren gjatë kryerjes së detyrave tona.

Mendojmë se është emergjente dhe e domosdoshme blerja e një automjeti tjetër zjarrëfikës që do të ndikojë në përmbushjen e detyrave tona për t'i ardhur në ndihmë komunitetit në rast nevoje.

Përgjegjësi i M.Z.SH.-së/Bashkia Lushnje

Inspektor: Xhezmi Metushi

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com